



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVA – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT,  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION,  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of Ministar

Kancelarija Ministra

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

**NUMER: 13/2004**

**DATA: 17.05.2004**

**LËNDA: ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR KLASËN E DYTË (II).**

Në bazë të nenit 6.1 paragrafi (b), si dhe nenit 7.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe në përputhje me nenin 1.3 pika (ç) të Rregullores numër 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi degen e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

### **Neni 1**

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i Planit dhe programit mësimor për klasën e dytë (II), si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

### **Neni 2**

Plani dhe programi i ri për klasën e dytë(II) i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

### **Neni 3**

3.1. Ky Plan dhe program për klasën e dytë(II) zbatohet nga viti shkollor 2004/2005.

3.2. Me zbatimin e Planit dhe të programit të klasës së dytë(II) shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së dytë(II) të shkollës fillore.

#### **Neni 4**

Ky udhëzim hyn në fuqi më nënshkrimin e Ministrit.

---

Mr. Rexhep Osmani, Ministër